REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Dragashit – Opština Dragaš – Municipality of Dragash

---

Kryetari i Komunës
02 Nr.400-540, 01 Nr. 400- 541
Dt: 08. 03. 2016
Dragash

Në bazë të kërkesës së parashtruar nga K.F "OPOJA" - Dragash, për ndihmë materiale për mbulimin e shpenzimeve për funkionimin e klubit, e bazuar në nenin 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 57 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Rregullorën për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Dragashit 01.nr.06-246/2 të datës 28.02.2013, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

I. **TË LEJOHEN** mjetet në shumë prej **1.000,oo Euro** për K.F. "OPOJA" në Dragash, në emër të mbeshtetjës financiare për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të klubit, në xhiro-llogarinë nr.1301001002037489-BpB.

II. Për implementimin e Vendimit **OBLIGOHET** Drejtoria për Financa, Ekonomi e Zhvillim e Komunës.

III. Mjetet të lejohen nga pozicioni buxhetor i subvencioneve e transfereve nga zyra e kryetarit të Komunës.

IV. Për veprimet e ndërmarra të njoftohet kryetari i Komunë

Shtojcë: kërkesat, Vendimi i KPF, dhe formulari për kërkesa dhe ankesa.

Vendimi i dërgohet :
- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës, dhe
- Parashtruesit të kërkesës dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Salim Jenuzi

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

---

- Kryetari i Komunës
02 Nr. 035-3600/16
Dt. 10. 03. 2016
D r a g a sh

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në bazë të nenit 57 të Statutit të Komunës - Dragash, kryetari i Komunës, lëshon këtë:

A U T O R I Z I M

1. Më të cilin autorizohet Zyra e Prokurimit - Menaxheri i Zyrës së Prokurimit të Komunës, se ka të drejtë që ti formoj komisionet për hapje dhe vlerësim për të gjitha projektet e Komunës së Dragashit, për vitin 2016.

2. Autorizimi për shkaqe tjera nuk vlen.

Kryetari i Komunës
Salim Jenuzi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
Nr. Br. 400 - 3826
14. 3. 2016
Dragash - Dragaš

Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Municipality Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas

Data /ë :14.03.2016

Referenca : Letër e Përkrahjes

Për : OJQ-në –"Shoqat Inciativa e Grave ", Dragash

Nga : Kryetari i Komunës – z.Salim Jonuzi

Duke u bazuar në rrethanatë aktuale që ndodhet Komuna jonë nga njëra anë por edhe obligimet që na ngarkohen me ligj ,si udhëhqje komunale nga ana tjetër domosdo bashëkupunimi me shoqërin civile është mëse i nevojeshëm për tju dalim në ndihmë qyterarëve që të krijojmë një abientë të përshtatëshëm për të gjitha komunitete por edhe të dy gjinitë që të vijnë në shprehje rrespektimi i kërekesat dhe të drejtave të tyre .

Kështu që Komuna e Dragashit që disa vite e ka ndërtuar një bashëkpunim shumë të shëndosh dhe të siqertë me OjQ-në "Shoqata Inciativa e Grave ",por kjo është arrituar fal seriozitet, përkushtimit dhe sukseve të saj ,të arritur me anë të projekteve të realziuar për brenda Dragashit .

Projektet të cilat janë të realziaur nga kjo OJQ ,janë gjithëmon në përputhje me objektivat e Plani Komunal për Barazi Gjionre por edhe me planeve tjera zhvillimore komunale.

Përvoja e impemtimit të projekteve nga vitin në vit por edhe nevoja dhe natyra e këtij projekti "Aktivizimi i grave për qeverisje efikase lokale në fushën e Barazis Gjinore'' të cilin po aplikon OJQ- ,na bëjnë më të bindur që të jemi edhe me tutje mëbeshtetës dhe përkrahës në realizimin aktiviteteve të këtij projekti .

Bashëkpunim dhe mbështetja jonë nuk do ti mungoj andaj kërkojmë mirëkuptim dhe dhënjen e mundësisë nga ana juaj .

Me rrespekt

Kryetar I Komunes se Dragashit, Salim Jonuzi

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E DRAGASHIT • KUVENDI KOMUNAL • SKUPŠTINA OPŠTINE DRAGAŠ • REPUBLIC OF KOSOVO

14.03.2016

Pranoi: Linduta Kamaqi - Piraj

Qendra Rinore
AVOKO
Dragash

Marrëveshje Bashkëpunimi për ndarje te shpenzimeve:

në mes të

Qendra Rinore Avoko- Dragash dhe

Komuna e Dragashit për projekti "Të Luajmë së Bashku"

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Nr. Br. 400-4670
29.3 2016
Dragash - Dragaš

NENI 1

Qëllimi- Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëfinancimin e projektit 'Të luajmë së Bashku' projekt ky I financuar nga Ambasada Zvicerane në Kosovë, dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, që ka për qëllim, formimin e grupeve multikulturore të artit në Komunën e Dragashit të përbërë nga të rinj shqiptar dhe goran me qëllim të promovimit të artit dhe ngritjes së komunikimit ndërkulturor mes të rinjve të kësaj komune.

NENI 2

Përgjegjësitë e OJQ Avoko- OJQ Avoko do të formoj grupet multikulturore të artit si dramë, pikturë dhe muzikë, ku përmes artistëve këta të rinj do të zhvillojnë aktivitete të artit, dhe në fund do të organizohen shfaqje teatrale, ekspozite të pikturave dhe koncerte muzikorë. Avoko do të përgatis raporte për punën e grupeve, të cilat grupe do të takohen çdo javë për të zhvilluar aktivitete të artit, si dhe do të dorëzojë raport, narrativ dhe financiar sipas propozimit.

NENI 3

Përgjegjësitë e Komunës se Dragashit- Komuna e Dragashit do të bashkë-financoj këtë projekt me shumën 300 euro, për të mbuluar shpenzimet e grupeve të artit si dhe për organizimin e eventeve të përbashkëta , si ekspozitë te pikturës, shfaqje teatrale dhe koncer muzikor.

NENI 4

Ndarja e shpenzimeve- Ambasada Zvicerane në Kosovë ka mbështetur këtë projekt me 5050 euro, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me 1750 ndërsa Komuna e Dragashit me 2500 euro

NENI 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit

Sotir Jorguzi- Kryetar i Komunës së Dragashit

Jeton Qengaj- Drejtor Ekzekutiv Avoko

Dragash Mars 2016

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës
02 Nr. 400 – 4678
Dt. 29. 03. 2016
D r a g a sh

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

1. **EMËROHET z.Džulbehar Taipi** menaxher për mbikëqyrjen e punimeve në projektin: **"Asfaltim i rrugës Brrut – Blaç"** - Komuna Dragash.

2. Për implementimin e këtij Vendimi obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës.

3. Detyrë e menaxherve është mbikëqyrja e punimëve, hartimi i procesverbalit – raportit dhe njoftimi i organeve të lartëcekura, për procedurat e më tejme.

4. Për hapat e ndërmarra të njoftohet kryetari i komunës.

I dërgohet:
- Menaxherit të punimëve,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Salim Jenuzi

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality

- **Kryetari i Komunës**
02 Nr. 900-4629
Dt. 29. 03. 2016
D r a g a sh

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

1. **EMËROHET z.Amdija Šeapi** menaxher për mbikëqyrjen e punimeve në projektin: **"Kubëzimi i rrugëve në fsh.Zaplluxhe"** - Komuna Dragash.

2. Për implementimin e këtij Vendimi obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës.

3. Detyrë e menaxherve është mbikëqyrja e punimëve, hartimi i procesverbalit – raportit dhe njoftimi i organeve të lartëcekura, për procedurat e më tejme.

4. Për hapat e ndërmarra të njoftohet kryetari i komunës.

I dërgohet:
- Menaxherit të punimëve,
- Zyrës së Prokurimit të Komunës,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës, dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës
Salim Jonuzi